

SKEMA E GRANTEVE 'ALTERNATIVE PATHWAYS' LOT 3

Festivali Rajonal i Veriut për të rinj aktiv dhe krijues

Objektivi i këtij Loti është krijimi i një Festivali vjetor për të rinjtë në Veri të Shqipërisë, që do të identifikojë, promovojë dhe zhvillojë aftësi krijuese dhe sipërmarrëse tek të rinjtë në zonën e veriut të Shqipërisë, në art dhe kulturë, trashëgimi kulturore dhe natyrore, turizëm dhe agroturizëm, multimedia dhe audiovisual, si dhe në aktivizëm dhe angazhim qytetar.

Programi 'Alternative Pathways' synon të krijojë një platformë të qëndrueshme për promovimin dhe zhvillimin e kapaciteteve krijuese dhe sipërmarrëse të talenteve të rinj nga veriu, zhvillimin e aftësive dhe njohurive të reja, krijimin e mundësive të reja social-ekonomike dhe mundësimin e lëvizshmërisë sociale për të rinjtë.

Aktivitetet e propozuara

Propozimi i projektit duhet të përfshijë shumicën e aktiviteteve më poshtë, por jo vetëm:

- Aktivitete për **ngritjen e kapaciteteve** për të rinjtë: trajnime, seminare, mentorim dhe trajnim mbi inisiativa sipërmarrëse dhe/ose krijuese që lidhen me trashëgiminë kulturore dhe natyrore të veriut të Shqipërisë, artin dhe krijimtarinë, mobilizimin e komunitetit dhe angazhimin qytetar
- Krijimi i një **koalicioni rajonal verior** për organizimin e Festivalit, duke përfshirë hartimin dhe zbatimin e programit të zhvillimit të kapaciteteve për anëtarët e koalicionit
- **Organizimi i Edicionit të parë të Festivalit** që do të mbledhë të rinj të moshës 16–20 vjeç, nga të paktën tetë bashki në veri, duke ndërthurur zhvillim aftësish të reja, aksione kreative, krijim dhe prezantim produkte kreative multimediale apo artistike, ekspozita, shfaqje dhe ngjarje të tjera tërheqëse dhe argëtuese për të rinjtë, etj.
- **Inisiativa lokale** përgatitore përpara Festivalit dhe/ose **aksione vijuese lokale** pas Festivalit
- **Vizita studimore** për të rinj të përzgjedhur, në festivale të tjera të ngjashme në vend ose në rajon
- Etj.

Kush mund të aplikojë

Aplikantët e mundshëm mund të jenë:

Organizatat e shoqërisë civile që plotesojnë sa më poshtë:

- Eksperiencë në hartimin dhe zbatimin e projekteve të ngjashme në fushëveprim dhe buxhet
- Partneritet me organizata të tjera lokale dhe rajonale, shkollat, bashkitë, biznese lokal
- Njohuri dhe kuptueshmeri të mirë të mentalitetit dhe sfidave social-ekonomike të veriut, veçanërisht të rinisë
- Njohuri të mira dhe përvojë në inisiativa të trashëgimisë kulturore, sektorit krijues, ne arti dhe kulturë, dhe/ose në nisma të sipërmarrjes së turizmit dhe agroturizmit
- Nëse organizata aplikuese nuk është nga zona e veriut, atëherë partneriteti me të paktën një partner lokal nga veriu është **një kërkesë e detyrueshme** (organizata lokale, shkolla, pushteti lokal dhe grupe joformale lokale)
- Inkurajohet ekspertiza/know-how dhe rrjetëzimi ndërkombëtar

Buxheti

Maksimumi 53,000 GBP